



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.535/5 prot

Datë 17.03.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 400/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.03.2026 shqyrtoi kërkesën me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar –”, me REF-76114-02-13-2026 me objekt: “Blerje preparate për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim”, me fond limit 55 581 450 (pesëdhjetë e pesë milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH ose 575 734.9 (pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër pikë nëntë) euro pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 18.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK me NIPT M11815028I dhe adresë: Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr.8240, Njësia Nr.6., Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë. Rruga “5 Maji”, Godina 17, Tregu i Medresesë, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 24 e vijues, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë

13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 16.02.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar –”, me REF-76114-02-13-2026 me objekt: “Blerje preparate për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim”, me fond limit 55 581 450 (pesëdhjetë e pesë milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH ose 575 734.9 (pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e

katër pikë nëntë) euro pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 18.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 20.02.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6347 dhe me nr. 535 prot., datë 20.02.2026 e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK me anë të së cilës ka kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi si më poshtë:

*[.....]Pasi u njohëm me DT rezulton se ato janë hartuar në kundërshtim të hapur me Ligjin duke favorizuar OE të paracaktuar. Në këto kushte, bazuar në LPP dhe RrPP paraqesim këtë ankesë duke kërkuar modifikimin e dokumentave të tenderit.*

*Në shotjcën numër 7 Specifikimet Teknike janë kërkuar:*

*Adulticid për luftimin e grerëzave në fole në formë shkume. Ky produkt të jetë i gatshëm në formën e bombulave për spërkatje në formë spraji me efikasitet minimumi deri në 3 metra, për luftimin e grerëzave direkt në foletë e tyre. Valvula speciale e dërgon produktin në formë sprucimi dhe sapo godet folenë ai shndërrohet menjëherë në një shkumë të dendur dhe mbështjellëse që pengon insektet të fluturojnë duke realizuar në një kohë të shkurtër eliminimin e tyre. Lënda bazë aktive e këtij preparati duhet të jetë adulticid i klasës Piretroide dhe përbërës të tjerë të shtuar sipas produktit. Paketimi: Në konfeksion metalik me mekanizëm sprucimi në formë aerosoli 500ml-1000ml. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se ? e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.*

*Insekticid për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse si milingona, miza, pleshta, rriqna, morra, për ambjente të jashtme të godinave publike, arsimore, parqet publike, kanalizimet. Lëndët bazë aktive e këtij preparati duhet të jenë të klasës Piretroide në formë mikrokapsulare me efekt të menjëhershëm dhe të zgjatur. Preparati të jetë në formë të lëngshme, i tretshëm në ujë dhe i përshtatshëm për pajisjet dezinfektuese per pompat me presion të ulët. Toksiciteti i produktit sipas përcaktimit të OBSH të jetë i nivelit të ulët ose mesatar dhe i parrezikshëm për mjedisin. Duhet të ketë efekt të menjëhershëm godites dhe toksicitet të ulët/mesatar. Paketimi: Në konfeksion plastik 100 ml - 1 lt. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se ? e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.*

*Insekticid për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse milingona, miza, pleshta, rriqna, morra, për ambjente të brendshme të godinave publike, arsimore, bodrumet, vendstrehimet. Lëndët bazë aktive e këtij preparati duhet të jenë të klasës Piretroide në formë e mikrokapsuluar te gatshme pa pasur nevojën e shtimit te preparateve te tjera per te patur nje efekt të zgjatur. Preparati të jetë në formë të lëngshme, i tretshëm në ujë dhe i përshtatshëm për pajisjet dezinfektuese dhe i përshtatshëm per pompat me presion të ulët. Toksiciteti i produktit sipas përcaktimit të OBSH të jetë i nivelit të ulët ose mesatar dhe i parrezikshëm për mjedisin. Duhet të ketë efekt të menjëhershëm dhe toksicitet të ulët/mesatar duke mos lënë mbetje pas përdorimit. Paketimi: Në konfeksion plastik 100 ml-1 lt. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se ? e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.*

. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Është detyrë e njësisë së prokurimit hartimi i kriterëve të qarta të kualifikimit në mënyrë që OE të interesuar të kenë të gjithë informacionin e duhur për hartimin e ofertës. Produktet – objekt prokurimi janë për përdorim civil dhe mjedis urban dhe për këtë arsye duhet të importohen me autorizim të dhënë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pas vlerësimit nga Instituti i Shëndetit Publik si organi kompetent për dhënjen e autorizimeve për hedhjen në treg të produkteve biocide.

“Produktet Biocide me përmbajtje të lëndëve aktive të cituara ne DST, trajtohen sipas VKM nr. 933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”.

VKM nr 933 date 25.11.2020 përcakton saktë se çfarë dokumentacioni duhet të plotesojë njw operator ekonomik pwr marrjen e lejes se importit tw produkteve biocide nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale.

Në bazë të VKM nr. 933 datë 25.11.2020, operatori ekonomik duhet të paraqesë pranë Ministrisë së Shëndetësisë dokumentet;

? Leter Aksesit për lenden biocide e rregjistruar ne ECHA

? Leter aksesit për produktin e rregjistruar ne ECHA

? Autorizim prodhuesi

? Etiketen ne gjuhen Shqipe dhe te origjines

? MSDS ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen e origjines

? Certifikat rregjistrimi ne Europe, Kanada ose ne USA ne gjuhen Shqipe dhe te origjines

Ligji Nr. 10 489, datë 15.12.2011 PËR TREGTIMIN DHE MBIKËQYRJEN E TREGUT TË PRODUKTEVE JOUSHQIMORE parashikon se me çfarë dokumentacioni duhet të pajisjet operatori ekonomik për të hedhur në treg produktet jo ushqimore që janë ato që kërkon të prokurojë AK.

Në pikën 2 të nenit 2 të këtij Ligji parashikohet “Ky ligj nuk zbatohet për substancat kimike që janë objekt i regjistrimit dhe/ose autorizimit paraprak dhe produktet kozmetike.

Në lidhje me ligjin për biocidet, të cilin Shqipëria ka miratuar, mund të importohen dhe autorizohen vetëm produktet që janë përfshirë në listën ECHA si përbërës aktivë dhe janë të regjistruara në Evropë si biocide gjithmonë në të njëjtën listë. Në të kundërt, Ministria Shqiptare e Shëndetësisë nuk jep asnjë autorizim për produkte që nuk plotesojmë këto kriteret. Theksojmë gjithashtu se produktet insekticide që tani janë bërë biocide me lënd aktive si deltametrinë, cipermetrinë dhe ekuivalent sipas të dhënave të cituara në etiketë nuk mund të përdoren në ambientet e jashtme dhe për këtë arsye nuk janë më të përdorshme me sistemet ULV ose në ndonjë metodë tjetër me nebulizim në një mjedis të jashtëm. Këto produkte mund të importohen vetëm nëpërmjet një kanali tjetër që është Ministria e Bujqësisë, por në këtë rast produktet duhet të përdoren për të luftuar insektet e bimëve dhe mbi produktet bujqësore, për këtë arsye kjo do të ishte në kundërshtim me indikacionet në etiketë. Nga AK është kërkuar një tjetër gamë insektetsh që është ajo urbane, dhe nëse pranohet që produktet të

jenë futur si produkte bujqësore kemi të bëjmë me përdorim jo të duhur dhe të paautorizuar. Po kështu, e njëjta gjë vlen edhe për dezinfektuesit, të cilët duhet të jenë gjithmonë të autorizuar për sasinë e importuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe jo këto produkte të importohen si produkte për përdorim veterinar apo për ferma (të autorizuar nga Ministria e Bujqësisë), por për mjedise civile, spitale, shtëpi, industri ushqimore etj.

Sa më sipër kërkojmë modifikimin e produktit nr 4, specifikimet teknike në: Adulticid për luftimin e grerëzave direkt në foletë e tyre, në formë shkume. Produkti duhet të jetë i gatshëm për përdorim, në formën e bombulave për spërkatje (spray), me efikasitet sprucimi minimumi deri në 3 metra, për aplikim të drejtpërdrejtë në foletë e grerëzave. Valvula speciale duhet të mundësojë shpërndarjen e produktit në formë sprucimi, i cili në momentin e kontaktit me folenë të shndërrohet në shkumë të dendur dhe mbështjellëse, duke penguar insektet të fluturojnë dhe duke realizuar eliminimin e tyre në një kohë të shkurtër. Lënda bazë aktive e preparatit duhet të jetë adulticid i klasës Piretroide ose ekuivalente, e autorizuar për përdorim në kontrollin e organizmave të dëmshëm në shëndetin publik, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe përbërës të tjerë ndihmës sipas formulimit të produktit.

Në konfeksion metalik me mekanizëm sprucimi në formë aerosoli, 500 ml – 1000 ml.

Sa më sipër kërkojmë modifikimin e produktit nr 5, specifikimet teknike në: Insekticid për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse (milingona, miza, pleshta, rriqna, morra), për përdorim në ambiente të brendshme dhe/ose zona të jashtme të godinave publike, arsimore, parqe publike dhe kanalizime, vetëm në përputhje me autorizimin e produktit. Lëndët aktive duhet të jenë të klasës Piretroide ose ekuivalente, ose produkte me veprim mekanik, të autorizuar për përdorim urban. Produkti mund të jetë në formë mikrokapsulare ose në formulim tjetër ekuivalent të autorizuar. Në rast përdorimi në zona të jashtme, aplikimi duhet të kryhet vetëm me metoda të lejuara sipas etiketës dhe autorizimit të produktit, duke përjashtuar metodën ULV (nebulizim hapësinor), përveç rasteve kur kjo metodë është shprehimisht e autorizuar. Produkti të jetë në formë të lëngshme ose në formë tjetër të autorizuar, i përshtatshëm për pajisje aplikimi sipas etiketës. Toksiciteti sipas klasifikimit të OBSH të jetë i nivelit të ulët ose mesatar, paketimi: 100 ml – 1 L.

Sa më sipër kërkojmë modifikimin e produktit nr 6, specifikimet teknike në: Insekticid për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse (milingona, miza, pleshta, rriqna, morra), për përdorim në ambiente të brendshme të godinave publike, arsimore, bodrume dhe vendstrehime, vetëm në përputhje me autorizimin e produktit. Lëndët bazë aktive duhet të jenë të klasës Piretroide ose ekuivalente, ose produkt me veprim mekanik (fizik), të autorizuar për përdorim në kontrollin e organizmave të dëmshëm në shëndetin publik. Produkti mund të jetë në formë të lëngshme, pluhur gati për përdorim (ready-to-use) ose në formulim tjetër të autorizuar, me efekt të menjëhershëm dhe/ose efekt të zgjatur sipas autorizimit. Produkti të jetë i përshtatshëm për pajisjet e aplikimit sipas etiketës dhe autorizimit përkatës.

Në lidhje me afatin e jetëgjatësisë “data e skadencës në ditën e lëvrimit të mos jetë më e vogël se ? e periudhës ndërmjet datës së prodhimit dhe datës së skadencës” të vendosur në të gjitha produktet

e kërkuara, me miratimin e V.K.M. nr 933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre

në treg”; ndryshuan edhe kërkesat për autorizimin e importit të këtyre produkteve në Republikën e Shqipërisë. Nga një përllogaritje del hapur që këto produkte do ti dërgohen AK të skaduara sepse produktet biocide kanë jetëgjatësi 2 deri 3 vite nga data e prodhimit. Duke

*qënë se pas miratimit të VKM nr. 933 date 25.11.2020 marrja e këtij autorizimi është e pamundur për produktet që nuk janë biocide atëherë rezulton se produktet janë futur në vendin tonë, nga OE i përzgjedhur nga AK, si produkte me orientim bujqësor dhe shiten si produkte për përdorim urban, pra në kundërshtim të hapur me Ligjin.*

*Sa më sipër kërkojmë rregullimin e këtij përcaktimi bazuar në detyrimet ligjore.*

*Lidhur me kriterin 2.2.3 Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi produkte insekticidë, adulticidë dhe rodenticidë (produktet me nr.1,2,3,4,5,6,7,8,10 në tabelën e Shtojcës 7), duhet të paraqesë autorizim për bërjen të disponueshme në treg ose autorizim importi të produkteve biocide për kontrollin e organizmave të dëmshëm në shëndetin publik, të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale sipas legjislacionit në fuqi.*

*2.2.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostrat (kampionet) ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit, nga jo më pak se një 1(një) kampion në paketim origjinal për produktet objekt prokurimi. Mostra e kërkuar duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues. Mostrat duhet të jenë të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në sistemin e publikimeve elektronike (SPE).*

*Lidhur me dy kriteret e sipër cituara ju si KPP keni dhene nje vendim me nr 392/2025, me date 21.03.2025, kerkojme heqjen e ketyre dy kriterave sipas vendimit te cituar.*

*Ne perfundim kerkojme modifikimin e mallrave objekt prokurimi 4-5-6 duke u bazuar ne ato qe kemi cituar dhe heqjen e kriterve te sipër cituara per te patur nje procedure prokurimi te “hapur” duke nxitur pjesemaren e shume OE, respektuar edhe Ligjine e Prokurimit Publik, Neni 2, Neni 3.”*

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 851/3 prot., datë 02.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 535/1 pr., datë 05.03.2026, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik kthimi i përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues, dhe në përfundim ka vendosur mos pranimin e ankesës.

II.5. Në datën 10.03.2026 pranë Komisionit Prokurimit Publik është protokolluar më shkresën nr. 535/2 prot., “Formulari i Paraqitjes së Argumentave nga Operatori Ekonomik i Interesuar “Albania Distribution Chemicals” SHPK”, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, lidhur me vendimin e AK përsa i përket ankesës së tij.

### III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimin operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK, për modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.2.3 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në Shtojcën 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” pika 2.2.3 “*Kapaciteti Teknik*” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë:

“2.2.3 *Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi produkte insekticidë, adulticidë dhe rodenticidë (produktet me nr.1,2,3,4,5,6,7,8,10 në tabelën e Shtojcës 7), duhet të paraqesë autorizim për bërjen të disponueshme në treg ose autorizim importi të produkteve biocide për kontrollin e organizmave të dëmshëm në shëndetin publik, të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale sipas legjislacionit në fuqi.*”.

III.1.2. Në dokumentet e tenderit, Shtojcën 6 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*” autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike të artikujve objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

#### **Shtojca 6.**

**[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]**

#### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

*Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.*

*SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".*

*Skicimet, parametrat teknik etj:*

## **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

*1. Higjenizues me bazë hipoklorit kalciumi. {Calcium hypochlorite (Ca(OCl)<sub>2</sub>) CAS no.7778-54-3} në përqendrim 30%-40%; Ky preparat duhet të shërbejë për higjenizimin e ambjenteve dhe ujrave të ndotura. Paketimi: Në konfeksion plastik 20kg-50kg dhe sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.*

*2. Higjenizues me bazë hipoklorit natriumi. {Sodium hypochlorite (Na OCl) CAS no.7681-52-9} në përqendrim 12%-15%. Ky preparat duhet të përdoret për higjenizimin e tualeteve, myshkut, algave dhe si preparat për higjenizimin e sipërfaqeve dhe pajisjeve të ndryshme. Paketimi: në konfeksion plastik 5 deri 25 litra dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.*

*3. Higjenizues me bazë komponime të amonit kuaternar. Ky preparat duhet të përdoret për higjenizimin e ambjenteve të jashtme dhe të brendshme, i përshtatshëm për pajisjet spërkatëse të tipit ULV (mjegulluese) dhe pompat me presion të ulët. Spektri i veprimit të preparatit të përfshijë eliminimin e viruseve, baktereve, kërpudhave dhe mykut. Lëndët bazë aktive e këtij preparati higjenizues duhet të jenë komponime të amonit kuaternar, dhe përbërës të tjerë të shtuar sipas produktit. Preparati të jetë në formë të lëngshme dhe i tretshëm në ujë. Destinacioni i përdorimit: Në ambjente të brendshme dhe të jashtme si zyra, qendra sociale, shkolla, kopshte, rrugë, sheshe publike, vendgrumbullime mbeturinash, holle të hapura, sheshe pushimi, ambiente pritje jashtë, rrugica hyrëse-dalëse, mure të jashtme godine, mure rrethuese. Paketimi: në konfeksion plastik 1 deri 5 litra dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.*

*4. Adulticid për luftimin e grerëzave në fole në formë shkume. Ky produkt të jetë i gatshëm në formën e bombulave për spërkatje në formë spraji me efikasitet minimumi deri në 3 metra, për luftimin e grerëzave direkt në foletë e tyre. Valvula speciale e dërgon produktin në formë sprucimi dhe sapo godet folenë ai shndërrohet menjëherë në një shkumë të dendur dhe mbështjellëse që pengon insektet të fluturojnë duke realizuar në një kohë të shkurtër*

eliminimin e tyre. Lënda bazë aktive e këtij preparati duhet të jetë adulticid i klasës Piretroide dhe përbërës të tjerë të shtuar sipas produktit. Paketimi: Në konfeksion metalik me mekanizëm sprucimi në formë aerosoli 500ml-1000ml. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se  $\frac{1}{2}$  e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

5. Insekticid për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse si milingona, miza, pleshta, rriqna, morra, për ambjente të jashtme të godinave publike, arsimore, parqet publike, kanalizimet. Lëndët bazë aktive e këtij preparati duhet të jenë të klasës Piretroide në formë mikrokapsulare me efekt të menjëhershëm dhe të zgjatur. Preparati të jetë në formë të lëngshme, i tretshëm në ujë dhe i përshtatshëm për pajisjet dezinfektuese per pompat me presion të ulët. Toksiciteti i produktit sipas përcaktimit të OBSH të jetë i nivelit të ulët ose mesatar dhe i parrezikshëm për mjedisin. Duhet të ketë efekt të menjëhershëm godites dhe toksicitet të ulët/mesatar. Paketimi: Në konfeksion plastik 100 ml - 1 lt. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se  $\frac{1}{2}$  e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

6. Insekticid për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse milingona, miza, pleshta, rriqna, morra, për ambjente të brendshme të godinave publike, arsimore, bodrumet, vendstrehimet. Lëndët bazë aktive e këtij preparati duhet të jenë të klasës Piretroide në formë e mikrokapsular te gatshme pa pasur nevojën e shtimit te preparateve te tjera per te patur nje efekt të zgjatur. Preparati të jetë në formë të lëngshme, i tretshëm në ujë dhe i përshtatshëm për pajisjet dezinfektuese dhe i pershtatshem per pompat me presion të ulët. Toksiciteti i produktit sipas përcaktimit të OBSH të jetë i nivelit të ulët ose mesatar dhe i parrezikshëm për mjedisin. Duhet të ketë efekt të menjëhershëm dhe toksicitet të ulët/mesatar duke mos lënë mbetje pas përdorimit. Paketimi: Në konfeksion plastik 100 ml-1 lt. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se  $\frac{1}{2}$  e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

7. Insekticid për luftimin e furrtareve. Lënda bazë aktive e këtij preparati duhet të jetë Imidakloprid në trajtë xheli. Toksiciteti i produktit sipas përcaktimit të OBSH të jetë i nivelit i ulët ose mesatar dhe i parrezikshëm për mjedisin. Paketimi: Në konfeksion plastik në formë shiringe jo më shumë se 50g. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se  $\frac{1}{2}$  e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

8. Rodenticid për luftimin e minjve në mjedise të hapura dhe të mbyllura. Ky preparat duhet të jetë i tipit pellet, pastabite ose block. Lënda bazë aktive e rodenticidit duhet të jetë e klasës Antikoagulantë me veprim të ngadalshëm ose kronik. Toksiciteti i produktit sipas përcaktimit të OBSH të jetë i nivelit të ulët ose mesatar i parrezikshëm për mjedisin. Për të evituar kontaktin rodenticidit me gjallesat e tjera përveç minjve dhe për t'i ruajtur nga agjentët atmosferikë duhet të jenë të veshuara me një shtresë e cila të jetë hidhëruese me anë të lëndëve aktive si Bitrex (denatonium benzoate, CAS no. 3734-33-6) ose ekuivalentin e tij të destinuar për këtë qëllim. Paketimi: Në konfeksion plastik 0.1kg - 5kg i ndarë në copa nga

10-20g secila. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

9. Kuti plastike për vendosjen e rodenticiteve dhe monitorimin për përdorim në mjedise të mbyllura dhe të hapura me përdorim të gjërë, ku preparati është i futur në brendësi dhe nuk ka kontakt të jashtëm dhe mundësi vendosje letër ngjites për monitorimin e insekteve zvarritëse. Materiali i kutisë duhet të jetë rezistent ndaj agjentëve atmosferikë, shtypjeve dhe goditjeve dhe duhet të jetë i siguar me çelës sigurie për mbyllje të sigurtë. Përmasat: në forma të ndryshme me lartësi deri në 20cm me gjatësi dhe gjerësi deri 30cm dhe peshë maksimale 450g, me vrimë hyrje për minjtë me diametër 5cm-6cm.

10. Preparat repelent për largimin e gjarpërinjve dhe zvarranikëve. Ky preparat duhet të jenë i tipit repelent me formulim granular. Lënda bazë aktive e repelentit duhet të jetë natyrale e përbërë nga lloje të ndryshme vajrash bimorë e cila kur aplikohet krijon efekt mjedisi të papëlqyeshëm për zvarranikët, veçanërisht tek gjarpërinjtë dhe është e padëmshme për njerëzit, kafshët dhe shpendët. Paketimi: Në konfeksion plastik ose metalik 0.5-2 litra. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Të gjitha paketimet e preparateve objekt prokurimi duhet të jenë të etiketuara në gjuhën shqipe referuar nenit 1 pika 1.2 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.488, datë 29.06.2016 "Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve", pikës 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.487, datë 29.06.2016 "Për klasifikimin e produkteve biocide" dhe nenit 8 të Ligjit Nr.9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve".

III.1.3. Në dokumentet e tenderit, Shtojcën 7 "FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT" autoriteti kontraktor ka përcaktuar sasinë dhe grafikun e lëvrimit të artikujve objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

#### **Shtojca 7.**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

#### **FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

**Sasia e mallit që kërkohet:**

<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i mallrave</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>
<b>1</b>	Hipoklorid kalciumi	kg	8 000
<b>2</b>	Hipoklorid natriumi	litër	150

3	Higjenizues me baze komponime te amonit kuaternar	litër	1 850
4	Adulticid per luftimin e grerezave ne forme shkume	cope	450
5	Insekticid kundra insekteve fluturuese dhe zvarritëse në mjedise të hapura	litër	2 700
6	Insekticid kundër insekteve fluturuese dhe zvarritëse në mjedise të mbyllura	litër	900
7	Insekticid kundër furrtareve	kg	12
8	Rodenticide kundra brejtësve	kg	1 880
9	Kuti plastike për vendosjen e rodenticiteve	copë	500
10	Preparate për largimin e gjarpërinjve	litër	1 200

**Afatet e lëvrimit:**

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia	Afati i lëvrimit
1	Hipoklorid kalciumi	kg	8 000	6 (gjashte) muaj pas nënshkrimit
2	Hipoklorid natriumi	litër	150	6 (gjashte) muaj pas nënshkrimit
3	Higjenizues me baze komponime te amonit kuaternar	litër	1 850	6 (gjashte) muaj pas nënshkrimit
4	Adulticid per luftimin e grerezave ne forme shkume	cope	450	6 (gjashte) muaj pas nënshkrimit
5	Insekticid kundra insekteve fluturuese dhe zvarritëse në mjedise të hapura	litër	2 700	6 (gjashte) muaj pas nënshkrimit
6	Insekticid kundër insekteve fluturuese dhe zvarritëse në mjedise të mbyllura	litër	900	6 (gjashte) muaj pas nënshkrimit
7	Insekticid kundër furrtareve	kg	12	6 (gjashte) muaj pas nënshkrimit
8	Rodenticide kundra brejtësve	kg	1 880	6 (gjashte) muaj pas nënshkrimit
9	Kuti plastike për vendosjen e rodenticiteve	copë	500	6 (gjashte) muaj pas nënshkrimit

10	Preparate për largimin e gjarpërinjve	litër	1 200	6 (gjashte) muaj pas nënshkrimit
----	---------------------------------------	-------	-------	----------------------------------

Shpjegim i termave: **DPOP** → Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë

III.1.4. Në procesverbalin e datës 10.02.2026 “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM ” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.2.3 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” dhe specifikimet teknike të artikujve objekt prokurimi të përcaktuar në Shtojcën 6 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, si më poshtë vijon:

*“Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) e VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 8 pika 1 e Ligjit nr.95/2015 datë 17.09.2015 ”Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se pëmbushin kriteret ligjore për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore..*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm përbërë nga specialistë të fushës, i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjit nr.95/2015 datë 17.09.2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”, Ligjit nr.27/2016 datë 17.03.2016 “Për menaxhimin e kimikateve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.488, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”, VKM nr.933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”.*

*Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke u bazuar në nevojat reale të përdorimit të mallrave objekt të prokurimit. Produktet e kërkuara janë të rëndësishme në ushtrimin e detyrave funksionale të autoritetit kontraktor. Këto produkte garantojnë marrjen e masave efikase për parandalimin e infeksioneve nga viruset, bakteret, kërpudhat sipas detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Karakteristikat teknike dhe përbërësit kimikë të produkteve janë kërkuar në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM nr.933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide*

*dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”. Standartet teknike të kërkuara janë konsultuar me bazën ligjore në fuqi ku është verifikuar përcaktimi teknik për çdo element në veçanti. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.*

*Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 5 të Dokumentave Standarte të Tenderit.*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

III.1.6. Në Nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se:

*“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërsa në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

*“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.7. Në Nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.1.9. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim” pikat 1 dhe 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikon shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”.

III.1.9. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për mallrave”, pika 5 dhe pika 6 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.

III.1.10. Në nenin 3 “Fusha e veprimit”, nenin 8 “Autorizimi për bërjen të disponueshme për treg të produkteve biocide” dhe nenin 9 “Vendosja në treg e produkteve biocide” të ligjit Nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

### Neni 3

#### **Fusha e veprimit**

1. Ky ligj zbatohet për:

a) përdorimet, në shëndetin publik, të produkteve biocide;

b) produktet që shkatërrojnë, pengojnë apo kthejnë në të padëmshëm organizmat e dëmshëm për shëndetin, përmes rrugëve kimike ose biologjike të veprimit.

2. Ky ligj nuk zbatohet për:

- a) përdorimet jobiocide të produkteve dhe lëndëve vepruese;
- b) produktet që shkatërrojnë, pengojnë apo kthejnë në të padëmshëm organizmat e dëmshëm për shëndetin publik, nëpërmjet rrugës fizike të veprimit dhe jo rrugëve kimike ose biologjike;
- c) produktet e rregulluara me akte të tjera ligjore, si: produktet e mbrojtjes së bimëve, barnat mjekësore për përdorim human, barnat mjekësore për përdorim veterinar, pajisjet mjekësore, lëndët kozmetike.

3. Parashikimet e këtij ligji nuk bien ndesh me dispozitat e legjislacionit përkatës që trajton çështje që kanë lidhje me produktet biocide.

#### Neni 8

##### **Autorizimi për bërjen të disponueshme për treg të produkteve biocide**

1. Të gjitha lëndët vepruese dhe produktet biocide për kontrollin e organizmave të dëmshëm për shëndetin publik, që hyjnë, prodhohen dhe/ose përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhen të disponueshme për treg pas pajisjes me autorizim nga autoriteti kompetent.

2. Autoriteti kompetent autorizon produktet biocide, duke lejuar bërjen të disponueshme për treg në territorin e Republikës së Shqipërisë, pas paraqitjes së dokumentacionit nga personi fizik ose juridik dhe verifikimit nëse dosja i përmbush kërkesat, sipas këtij ligji.

3. Ministri përgjegjës për shëndetësinë, për raste të gjendjeve të emergjencës shëndetësore apo emergjencës civile, kur luftimi i një agjenti biologjik të dëmshëm gjykohet se nuk realizohet me produktet biocide të autorizuar, autorizon importimin dhe përdorimin e kufizuar të produkteve biocide të paautorizuara përmes procesit normal të bërjes së disponueshme për treg. Autorizimi është i vlefshëm për një periudhë deri në 4 muaj dhe për një sasi të argumentuar nga Instituti i Shëndetit Publik, sipas emergjencës.

4. Autorizimi për vendosjen në treg të produkteve biocide lëshohet për:

- a) produkte biocide të prodhuara në vend;
- b) produkte biocide të autorizuar në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian, në Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Turqi, Izrael dhe Australi;
- c) produktet biocide të prodhuara dhe të autorizuar në vendet e Ballkanit.

5. Rregullat për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe procedurën e dhënies së autorizimit të vendosjes në treg të produkteve biocide përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 9

##### **Vendosja në treg e produkteve biocide**

1. Produktet biocide vendosen në treg pasi janë autorizuar, sipas procedurës së parashikuar në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Vendosja në treg e produkteve biocide kryhet nga persona fizikë ose juridikë të licencuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, të cilët, pavarësisht nga sasia e produktit, plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) për rastet e tregimit të produkteve biocide me rrezikshmëri të lartë kanë të kontraktuar një person, në pozicionin e drejtuesit teknik, të diplomuar në degët biologji, kimi, agronomi ose shëndet publik;

b) kanë mjedise të përshtatshme për ushtrimin e aktivitetit, garantojnë kushte për sigurinë e personelit;

c) kanë klasifikuar, paketuar dhe etiketuar produkte biocide, sipas dokumentacionit të autorizimit të produktit;

ç) për rastet e tregimit të produkteve biocide me rrezikshmëri të lartë kanë mjedise të veçanta tregtimi.

III.1.11. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

III.1.12. Nga shqyrtimi i kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.2.3 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit, vërehet, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar që operatorët ekonomikë ofertues për mallrat objekt prokurimi produkte insekticidë, adulticidë dhe rodenticidë (produktet me nr.1,2,3,4,5,6,7,8,10 në tabelën e Shtojcës 7), duhet të paraqesë autorizim për bërjen të disponueshme në treg ose autorizim importi të produkteve biocide për kontrollin e organizmave të dëmshëm në shëndetin publik, të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale sipas legjislacionit në fuqi, pasi referuar specifikimeve teknike të këtyre artkujve të përcaktuar në Shtojcën 6 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*” të dokumentave të tenderit këto artikuj janë produkte biocide dhe sipas parashikimeve të nenin 3 “*Fusha e veprimi*”, nenin 8 “*Autorizimi për bërjen të disponueshme*

për treg të produkteve biocide” dhe nenin 9 “Vendosja në treg e produkteve biocide” të ligjit Nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”, i ndryshuar këto produkte vendosen në treg vetëm kur prodhuesi apo importuesi i tyre pajisjet me autorizim nga autoriteti kompetent që në rastin e këtyre produkteve është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik amkimues i cili pretendon se: “Në lidhje me kriterin e mësipër gjykon se në rastin konkret kriteri lidhur me paraqitjen e lejes së importit të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë për mallrat objekt prokurimi në fakt i takon vetëm një kategori pjesëmarrësish në procedurën e prokurimit objekt ankimi e konkretisht ata që janë jo vetëm tregëtues të këtyre mallrave, por edhe importues të tyre faktin se në procedurën e prokurimit objekt ankimi kanë të drejtë të marrin pjesë jo vetëm tregëtarë që janë edhe importues të mallrave nga jashtë, por edhe tregëtarë që e blejnë produktin e importuar në tregun vendas ose e blejnë nga prodhuesi dhe nuk kanë përse të disponojnë leje importi nga autoritetet kompetente. ... Në pikën 1 të Vendimit nr. 415, datë 17.08.1993 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin e eksportit, importit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të substancave për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim parashikohet se: “Importimi, eksportimi, magazinimi dhe tregtimi me shumicë e pakicë i lëndëve dezinfektante, dezinfektante e deratizuese për persona komunal, në banesa dhe objekte të ndryshme sociale nga persona juridikë e fizikë, si dhe nga individë të ndryshëm, bëhet me leje (licencë) që jepet nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit.” gjykon se kuardi ligjor parashikon licencimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e importimit, eksportimit, magazinimit dhe tregëtimit me shumicë e pakicë, ndërkohë që pjesëmarrës në procedurën e prokurimit mund të jenë edhe subjekte të tjera të cilat përmbushin kriteret e vecanta të kualifikimit, por nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme.”, autoriteti kontraktor ka argumentuar si në vijim: “Sipas sqarimeve në Procesverbalin për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Krieteve për Kualifikim, Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi u është shpjeguar se vendosja e kriterit për autorizimin për bërjen të disponueshme në treg ose autorizimin e importit të produkteve biocide për kontrollin e organizmave të dëmshëm në shëndetin publik, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është i bazuar në nenin 8 pika 1 e Ligjit nr.95/2015 datë 17.09.2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” i cili parashikon: “I. Të gjitha lëndët vepruese dhe produktet biocide për kontrollin e organizmave të dëmshëm për shëndetin publik, që hyjnë, prodhohen dhe/ose përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhen të disponueshme për treg pas pajisjes me autorizim nga autoriteti kompetent.”, kjo dispozitë ligjore është një dispozitë ligjore detyruese për Autoritetin Kontraktor, procedura e prokurimit ka për objekt produkte me lëndë vepruese për organizmat e dëmshëm për shëndetin publik, Autoriteti Kontraktor sipas dispozitave ligjore të ligjit Nr.95/2015 datë 17.09.2015 nuk mundet të prokurojë asnjë mall, i cili nuk është i pajisur me autorizim për vendosje në treg sipas përcaktimeve ligjore të mësipërme të këtyre lëndëve. Autorizimi për bërjen të disponueshme në treg nuk pengon asnjë Operator Ekonomik të blejë mallrat e

*përcaktuara në pikën 2.3.3 në tregtarë të cilat kanë importuar këto pasi bazuar në dispoziten ligjore të sipërcituar pa një autorizim vendosje në treg sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore të ligit Nr.95/2015 datë 17.09.2015 nuk mund të tregtohen në Republikën e Shqipërisë këto mallra. Ky kriter është vendosur në përputhje të plotë me vendimit Nr.918/2022 datë 22.09.2022 të Komisionit të Prokurimit Publik i cili vendos: “Nga shqyrtimi i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.918/2022, në pikën III.2.7. faqe 13, rezulton: ...”kriteri i hartuar nga autoriteti kontraktor për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit për produkte të caktuara (referuar shtojcës 6 të DST produktet me nr. 4-8) është në përputhje me parashikimet ligjore të mësipërme, pasi ligjvënasi e ka përcaktuar qartë, se jo vetëm lëndët vepruese dhe produktet biocide që hyjnë, por edhe ato që prodhohen dhe/ose përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë për t’u bërë të disponueshme në treg, duhet të jenë të pajisura me autorizim nga autoriteti kompetent, prandaj pretendimi i operatorit ekonomik ankimes për heqjen e këtij kriteri nuk qëndron.”*, duke evidentuar përcaktimin ligjor që subjektet prodhuese ose importuese të këtyre produkteve duhet të jenë të pajisur me autorizimin përkatës për vendosjen në treg të këtyre produkteve.

Lidhur me përcaktimet e bëra nga autoriteti kontraktor në këtë kriter kualifikues KPP sqaron faktin se në procedurën e prokurimit objekt ankim kanë të drejtë të marrin pjesë jo vetëm tregëtarë që janë edhe importues të mallrave nga jashtë dhe prodhuesit vendas të këtyre produkte, por edhe tregëtarë që e blejnë produktin e importuar në tregun vendas nga prodhuesi vendas apo nga tregtari që e ka importuar, të cilët nuk kanë përse të disponojnë autorizim për bërjen të disponueshme në treg ose autorizim importi të produkteve biocide për kontrollin e organizmave të dëmshëm në shëndetin publik, të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale sipas legjislacionit në fuqi.

Sa më sipër, KPP gjykon se kuardi ligjor parashikon licencimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e importimit, eksportimit, magazinimit dhe tregëtimit me shumicë e pakicë, ndërkohë që pjesëmarrës në procedurën e prokurimit mund të jenë edhe subjekte të tjera të cilat përmbushin kriteret e veçanta të kualifikimit, por nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme. KPP thekson se, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit (parashikuar nga neni 2 gërma “b” dhe “c” e lex specialis janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Referuar sa më lart KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e vecantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.3 “*Kapaciteti teknik*” të Shtojcës 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit, duke e përshtatur atë me dispozitat ligjore në fuqi dhe me qëllim edhe nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe rritjes së konkurrencës duhet të cilësojë në kriter se autorizimi për bërjen të disponueshme në treg ose autorizim importi të produkteve biocide për kontrollin e organizmave të dëmshëm në shëndetin publik, të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të bëhet e kërkueshme në rastin kur ofertuesi shfaqet në cilësinë e importuesit apo prodhuesit të artikujve objekt prokurimi me

numër rendor nr.1, nr.2, nr.3, nr. 4, nr.5, nr.6, nr.7, nr.8, dhe nr.10 të përcaktuar në Shtojcën 7 “*FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT*” të po këtyre dokumentave.

### **Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.**

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*Albania Distribution Chemicals*” SHPK të parashtruara në ankesën e sipërpërmendur, për modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.2.7 “*Kapaciteti teknik*” të Shtojcës 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në Shtojcën 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” pika 2.2.7 dhe “*Kapaciteti Teknik*” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë:

*“2.2.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostrat (kampionet) ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit, nga jo më pak se një 1(një) kampion në paketim origjinal për produktet objekt prokurimi. Mostra e kërkuar duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues. Mostrat duhet të jenë të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në sistemin e publikimeve elektronike (SPE)”.*

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojcën 6 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*” autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike të artikujve objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

### **Shtojca 6.**

*[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]*

### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

*Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.*

*SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një*

*Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".*

*Skicimet, parametrat teknik etj:*

## **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

*1. Higjenizues me bazë hipoklorit kalciumi. {Calcium hypochlorite (Ca(OCl)<sub>2</sub>) CAS no.7778-54-3} në përqendrim 30%-40%; Ky preparat duhet të shërbejë për higjenizimin e ambjenteve dhe ujrave të ndotura. Paketimi: Në konfeksion plastik 20kg-50kg dhe sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.*

*2. Higjenizues me bazë hipoklorit natriumi. {Sodium hypochlorite (Na OCl) CAS no.7681-52-9} në përqendrim 12%-15%. Ky preparat duhet të përdoret për higjenizimin e tualeteve, myshkut, algave dhe si preparat për higjenizimin e sipërfaqeve dhe pajisjeve të ndryshme. Paketimi: në konfeksion plastik 5 deri 25 litra dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.*

*3. Higjenizues me bazë komponime të amonit kuarternar. Ky preparat duhet të përdoret për higjenizimin e ambjenteve të jashtme dhe të brendshme, i përshtatshëm për pajisjet spërkatëse të tipit ULV (mjegulluese) dhe pompat me presion të ulët. Spektri i veprimit të preparatit të përfshijë eliminimin e viruseve, baktereve, kërpudhave dhe mykut. Lëndët bazë aktive e këtij preparati higjenizues duhet të jenë komponime të amonit kuarternar, dhe përbërës të tjerë të shtuar sipas produktit. Preparati të jetë në formë të lëngshme dhe i tretshëm në ujë. Destinacioni i përdorimit: Në ambjente të brendshme dhe të jashtme si zyra, qendra sociale, shkolla, kopshte, rrugë, sheshe publike, vendgrumbullime mbeturinash, holle të hapura, sheshe pushimi, ambiente pritje jashtë, rrugica hyrëse-dalëse, mure të jashtme godine, mure rrethuese. Paketimi: në konfeksion plastik 1 deri 5 litra dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.*

*4. Adulticid për luftimin e grerëzave në fole në formë shkume. Ky produkt të jetë i gatshëm në formën e bombulave për spërkatje në formë spraji me efikasitet minimumi deri në 3 metra, për luftimin e grerëzave direkt në foletë e tyre. Valvula speciale e dërgon produktin në formë sprucimi dhe sapo godet folenë ai shndërrohet menjëherë në një shkumë të dendur dhe mbështjellëse që pengon insektet të fluturojnë duke realizuar në një kohë të shkurtër eliminimin e tyre. Lënda bazë aktive e këtij preparati duhet të jetë adulticid i klasës Piretroide dhe përbërës të tjerë të shtuar sipas produktit. Paketimi: Në konfeksion metalik me*

mekanizëm sprucimi në formë aerosoli 500ml-1000ml. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se  $\frac{1}{2}$  e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

5. Insekticid për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse si milingona, miza, pleshta, rriqna, morra, për ambjente të jashtme të godinave publike, arsimore, parqet publike, kanalizimet. Lëndët bazë aktive e këtij preparati duhet të jenë të klasës Piretroide në formë mikrokapsulare me efekt të menjëhershëm dhe të zgjatur. Preparati të jetë në formë të lëngshme, i tretshëm në ujë dhe i përshtatshëm për pajisjet dezinfektuese per pompat me presion të ulët. Toksiciteti i produktit sipas përcaktimit të OBSH të jetë i nivelit të ulët ose mesatar dhe i parrezikshëm për mjedisin. Duhet të ketë efekt të menjëhershëm godites dhe toksicitet të ulët/mesatar. Paketimi: Në konfeksion plastik 100 ml - 1 lt. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se  $\frac{1}{2}$  e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

6. Insekticid për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse milingona, miza, pleshta, rriqna, morra, për ambjente të brendshme të godinave publike, arsimore, bodrumet, vendstrehimet. Lëndët bazë aktive e këtij preparati duhet të jenë të klasës Piretroide në formë e mikrokapsular te gatshme pa pasur nevojën e shtimit te preparateve te tjera per te patur nje efekt të zgjatur. Preparati të jetë në formë të lëngshme, i tretshëm në ujë dhe i përshtatshëm për pajisjet dezinfektuese dhe i pershtatshem per pompat me presion të ulët. Toksiciteti i produktit sipas përcaktimit të OBSH të jetë i nivelit të ulët ose mesatar dhe i parrezikshëm për mjedisin. Duhet të ketë efekt të menjëhershëm dhe toksicitet të ulët/mesatar duke mos lënë mbetje pas përdorimit. Paketimi: Në konfeksion plastik 100 ml-1 lt. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se  $\frac{1}{2}$  e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

7. Insekticid për luftimin e furrtareve. Lënda bazë aktive e këtij preparati duhet të jetë Imidakloprid në trajtë xheli. Toksiciteti i produktit sipas përcaktimit të OBSH të jetë i nivelit i ulët ose mesatar dhe i parrezikshëm për mjedisin. Paketimi: Në konfeksion plastik në formë shiringe jo më shumë se 50g. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se  $\frac{1}{2}$  e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

8. Rodenticid për luftimin e minjve në mjedise të hapura dhe të mbyllura. Ky preparat duhet të jetë i tipit pellet, pastabite ose block. Lënda bazë aktive e rodenticidit duhet të jetë e klasës Antikoagulantë me veprim të ngadalshëm ose kronik. Toksiciteti i produktit sipas përcaktimit të OBSH të jetë i nivelit të ulët ose mesatar i parrezikshëm për mjedisin. Për të evituar kontaktin rodenticidit me gjallesat e tjera përveç minjve dhe për t'i ruajtur nga agjentët atmosferikë duhet të jenë të veshuara me një shtresë e cila të jetë hidhëruese me anë të lëndëve aktive si Bitrex (denatonium benzoate, CAS no. 3734-33-6) ose ekuivalentin e tij të destinuar për këtë qëllim. Paketimi: Në konfeksion plastik 0.1kg - 5kg i ndarë në copa nga 10-20g secila. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se  $\frac{1}{2}$  e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

9. Kuti plastike për vendosjen e rodenticiteve dhe monitorimin për përdorim në mjedise të mbyllura dhe të hapura me përdorim të gjërë, ku preparati është i futur në brendësi dhe nuk ka kontakt të jashtëm dhe mundësi vendosje letër ngjites për monitorimin e insekteve zvarritëse. Materiali i kutisë duhet të jetë rezistent ndaj agjentëve atmosferikë, shtypjeve dhe goditjeve dhe duhet të jetë i siguar me çelës sigurie për mbyllje të sigurtë. Përmasat: në forma të ndryshme me lartësi deri në 20cm me gjatësi dhe gjerësi deri 30cm dhe peshë maksimale 450g, me vrimë hyrje për minjtë me diametër 5cm-6cm.

10. Preparat repelent për largimin e gjarpërinjve dhe zvarranikëve. Ky preparat duhet të jenë i tipit repelent me formulim granular. Lënda bazë aktive e repelentit duhet të jetë natyrale e përbërë nga lloje të ndryshme vajrash bimorë e cila kur aplikohet krijon efekt mjedisi të papëlqyeshëm për zvarranikët, veçanërisht tek gjarpërinjtë dhe është e padëmshme për njerëzit, kafshët dhe shpendët. Paketimi: Në konfeksion plastik ose metalik 0.5-2 litra. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Të gjitha paketimet e preparateve objekt prokurimi duhet të jenë të etiketuara në gjuhën shqipe referuar nenit 1 pika 1.2 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.488, datë 29.06.2016 "Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve", pikës 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.487, datë 29.06.2016 "Për klasifikimin e produkteve biocide" dhe nenit 8 të Ligjit Nr.9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve".

III.2.2. Në dokumentet e tenderit, Shtojcën 7 "FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT" autoriteti kontraktor ka përcaktuar sasinë dhe grafikun e lëvrimit të artikujve objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

#### **Shtojca 7.**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

#### **FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

**Sasia e mallit që kërkohet:**

<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i mallrave</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>
<b>1</b>	Hipoklorid kalciumi	kg	8 000
<b>2</b>	Hipoklorid natriumi	litër	150

3	Higjenizues me baze komponime te amonit kuaternar	litër	1 850
4	Adulticid per luftimin e grerezave ne forme shkume	cope	450
5	Insekticid kundra insekteve fluturuese dhe zvarritëse në mjedise të hapura	litër	2 700
6	Insekticid kundër insekteve fluturuese dhe zvarritëse në mjedise të mbyllura	litër	900
7	Insekticid kundër furrtareve	kg	12
8	Rodenticide kundra brejtësve	kg	1 880
9	Kuti plastike për vendosjen e rodenticiteve	copë	500
10	Preparate për largimin e gjarpërinjve	litër	1 200

#### Afatet e lëvrimit:

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Njësia	Sasia	Afati i lëvrimit
1	Hipoklorid kalciumi	kg	8 000	6 (gjashte) muaj pas nënshkrimit
2	Hipoklorid natriumi	litër	150	6 (gjashte) muaj pas nënshkrimit
3	Higjenizues me baze komponime te amonit kuaternar	litër	1 850	6 (gjashte) muaj pas nënshkrimit
4	Adulticid per luftimin e grerezave ne forme shkume	cope	450	6 (gjashte) muaj pas nënshkrimit
5	Insekticid kundra insekteve fluturuese dhe zvarritëse në mjedise të hapura	litër	2 700	6 (gjashte) muaj pas nënshkrimit
6	Insekticid kundër insekteve fluturuese dhe zvarritëse në mjedise të mbyllura	litër	900	6 (gjashte) muaj pas nënshkrimit
7	Insekticid kundër furrtareve	kg	12	6 (gjashte) muaj pas nënshkrimit
8	Rodenticide kundra brejtësve	kg	1 880	6 (gjashte) muaj pas nënshkrimit
9	Kuti plastike për vendosjen e rodenticiteve	copë	500	6 (gjashte) muaj pas nënshkrimit

10	Preparate për largimin e gjarpërinjve	litër	1 200	6 (gjashte) muaj pas nënshkrimit
----	---------------------------------------	-------	-------	----------------------------------

Shpjegim i termave: **DPOP** → Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë

III.2.3. Në procesverbalin e datës 10.02.2026 “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM ” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.2.7 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, si më poshtë vijon:

*“Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 488, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.487 pika 7, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin e produkteve biocide”, Udhëzimin nr.3478 datë 05.05.2014 “Për etiketimin dhe ambalazhimin e produkteve biocide, dezinfektuese, dezinfektuese, deratizuese për përdorim në shëndetin publik”, të Ministrisë së Shëndetësisë. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të kërkuara si mostra duke u nisur nga rëndësia që ato kanë për shkak të funksionalitetit special të tyre. Në këtë rast paraqitja e mostrave është konsideruar nga autoriteti kontraktor si e nevojshme pasi verifikimi fizik i tyre është gjykuar i rëndësishëm për të vlerësuar detyrimet ligjore të ambalazhimit dhe etiketimit të produkteve, sigurinë gjatë furnizimit së produkteve dhe sigurinë ndaj përdoruesve të tyre.”.*

III.2.4. Në Nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se:

*“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërsa në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

*“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

*2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

*3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.2.5. Në Nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

*“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.*

III.2.6. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim” pikat 1 dhe 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” parashikon shprehimisht se:

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që*

*operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”.*

III.2.7. Neni 40 “*Kërkesa të veçanta për mallrave*”, pika 6 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

*“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

*a) Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*

*b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*

*c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.*

III.2.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë, se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e

natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

III.2.9. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues të paraqitura në ankesë Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kërkesa për paraqitjen e mostrave për secilin prej artikujve të kërkuar nga autoriteti kontraktor është në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertuese zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. KPP konstaton, se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kriteret kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kriteret të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësisht të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave, por KPP gjykon, se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e mostrave për artikujt të veçantë të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, nuk është një kërkesë në përputhje me objektin e prokurimit, si dhe me volumin dhe përmasat e kontratës dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, si dhe kthimit të përgjigjes lidhur me këtë pretendim, autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë, se përse është e nevojshme paraqitja e mostrave të caktuara për këtë procedurë prokurimi. Mostra në vetvete ka qëllim verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor, qëllim i cili përmbushet nga operatorët ekonomikë me paraqitjen e skedës teknike ose katalogëve, të cilët autoriteti kontraktor në mënyrë alternative i ka kërkuar si kusht për kualifikim në pikën 2.2.4 “*Kapaciteti teknik*” të Shtojcës 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se verifikimi i përputhshmërisë së specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor me specifikimet teknike të artikujve, sigurohet nga operatorët ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit edhe përmes paraqitjes së skedës teknike apo katalogut siç është përcaktuar në dokumentet e tenderit. Në këtë kuadër KPP gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor e përcaktuar në pikën 2.2.7 të “*Kapaciteti teknik*” të Shtojcës 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, lidhur me paraqitjen e mostrave për të gjithë artikujt objekt prokurimi është një kërkesë e ekzagjeruar dhe në kundërshtim me qëllimin e lex specialis si dhe rregullat e prokurimit publik, të cilat kanë si synim nxitjen e konkurrencës dhe sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, prandaj autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e këtij kriteri për kualifikim nga dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

## **Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.**

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK të parashtruara në ankesën e sipërpërmendur, për modifikimin e specifikimeve teknike të produkteve nr.4; nr.5 dhe nr.6 të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, me pretendimin se “.....në lidhje me ligjin për biocidet, të cilin Shqipëria ka miratuar, mund të importohen dhe autorizohen vetëm produktet që janë përfshirë në listën ECHA si përbërës aktivë dhe janë të regjistruara në Evropë si biocide gjithmonë në të njëjtën listë. Në të kundërt, Ministria Shqiptare e Shëndetësisë nuk jep asnjë autorizim për produkte që nuk plotesojmë këto kritere. Theksojmë gjithashtu se produktet insekticide që tani janë bërë biocide me lënd aktive si deltametrinë, cipermetrinë dhe ekuivalent sipas të dhënave të cituara në etiketë nuk mund të përdoren në ambientet e jashtme dhe për këtë arsye nuk janë më të përdorshme me sistemet ULV ose në ndonjë metodë tjetër me nebulizim në një mjedis të jashtëm. Këto produkte mund të importohen vetëm nëpërmjet një kanali tjetër që është Ministria e Bujqësisë, por në këtë rast produktet duhet të përdoren për të luftuar insektet e bimëve dhe mbi produktet bujqësore, për këtë arsye kjo do të ishte në kundërshtim me indikacionet në etiketë. Nga AK është kërkuar një tjetër gamë insektetsh që është ajo urbane, dhe nëse pranohet që produktet të jenë futur si produkte bujqësore kemi të bëjmë me përdorim jo të duhur dhe të paautorizuar. Po kështu, e njëjta gjë vlen edhe për dezinfektuesit, të cilët duhet të jenë gjithmonë të autorizuar për sasinë e importuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe jo këto produkte të importohen si produkte për përdorim veterinar apo për ferma (të autorizuar nga Ministria e Bujqësisë), por për mjedise civile, spitale, shtëpi, industri ushqimore etj.

Sa më sipër kërkojmë modifikimin e produktit nr 4, specifikimet teknike në: Adulticid për luftimin e grerëzave direkt në foletë e tyre, në formë shkume. Produkti duhet të jetë i gatshëm për përdorim, në formën e bombulave për spërkatje (spray), me efikasitet sprucimi minimumi deri në 3 metra, për aplikim të drejtpërdrejtë në foletë e grerëzave. Valvula speciale duhet të mundësojë shpërndarjen e produktit në formë sprucimi, i cili në momentin e kontaktit me folenë të shndërrohet në shkumë të dendur dhe mbështjellëse, duke penguar insektet të fluturojnë dhe duke realizuar eliminimin e tyre në një kohë të shkurtër. Lënda bazë aktive e preparatit duhet të jetë adulticid i klasës Piretroide ose ekuivalente, e autorizuar për përdorim në kontrollin e organizmave të dëmshëm në shëndetin publik, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe përbërës të tjerë ndihmës sipas formulimit të produktit.

Në konfeksion metalik me mekanizëm sprucimi në formë aerosoli, 500 ml – 1000 ml.

Sa më sipër kërkojmë modifikimin e produktit nr 5, specifikimet teknike në: Insekticid për luftimin e insekteve fluturouese dhe zvarritëse (milingona, miza, pleshta, rriqna, morra), për përdorim në ambiente të brendshme dhe/ose zona të jashtme të godinave publike, arsimore, parqe publike dhe kanalizime, vetëm në përputhje me autorizimin e produktit. Lëndët aktive duhet të jenë të klasës Piretroide ose ekuivalente, ose produkte me veprim mekanik, të

autorizuara për përdorim urban. Produkti mund të jetë në formë mikrokapsulare ose në formulim tjetër ekuivalent të autorizuar. Në rast përdorimi në zona të jashtme, aplikimi duhet të kryhet vetëm me metoda të lejuara sipas etiketës dhe autorizimit të produktit, duke përjashtuar metodën ULV (nebulizim hapësinor), përveç rasteve kur kjo metodë është shprehimisht e autorizuar. Produkti të jetë në formë të lëngshme ose në formë tjetër të autorizuar, i përshtatshëm për pajisje aplikimi sipas etiketës. Toksiciteti sipas klasifikimit të OBSH të jetë i nivelit të ulët ose mesatar, paketimi: 100 ml – 1 L.

Sa më sipër kërkojmë modifikimin e produktit nr 6, specififikimet teknike në: Insekticid për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse (milingona, miza, pleshta, rriqna, morra), për përdorim në ambiente të brendshme të godinave publike, arsimore, bodrume dhe vendstrehime, vetëm në përputhje me autorizimin e produktit. Lëndët bazë aktive duhet të jenë të klasës Piretroide ose ekuivalente, ose produkt me veprim mekanik (fizik), të autorizuar për përdorim në kontrollin e organizmave të dëmshëm në shëndetin publik. Produkti mund të jetë në formë të lëngshme, pluhur gati për përdorim (ready-to-use) ose në formulim tjetër të autorizuar, me efekt të menjëhershëm dhe/ose efekt të zgjatur sipas autorizimit. Produkti të jetë i përshtatshëm për pajisjet e aplikimit sipas etiketës dhe autorizimit përkatës.. Në lidhje me afatin e jetëgjatësisë “data e skadencës në ditën e lëvrimit të mos jetë më e vogël se 1/2 e periudhës ndërmjet datës së prodhimit dhe datës së skadencës” të vendosur në të gjitha produktet e kërkuara, me miratimin e V.K.M. nr 933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”; ndryshuan edhe kërkesat për autorizimin e importit të këtyre produkteve në Republikën e Shqipërisë. Nga një përllogaritje del hapur që këto produkte do ti dërgohen AK të skaduara sepse produktet biocide kanë jetëgjatësi 2 deri 3 vite nga data e prodhimit. Duke qënë se pas miratimit të VKM nr. 933 date 25.11.2020 marrja e këtij autorizimi është e pa mundur për produktet që nuk janë biocide atëherë rezulton se produktet janë futur në vendin tonë, nga OE i përzgjedhur nga AK, si produkte me orientim bujqësor dhe shiten si produkte për përdorim urban, pra në kundërshtim të hapur me Ligjin..” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në dokumentet e tenderit, shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike” , autoriteti ka parashikuar si vijon::

#### **Shtojca 6.**

#### **[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ] FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të

marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

**SHËNIM:** Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

1. Higjenizues me bazë hipoklorit kalciumi. {Calcium hypochlorite ( $\text{Ca}(\text{OCl})_2$ ) CAS no.7778-54-3} në përqendrim 30%-40%; Ky preparat duhet të shërbejë për higjenizimin e ambjenteve dhe ujrave të ndotura. Paketimi: Në konfeksion plastik 20kg-50kg dhe sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se  $\frac{1}{2}$  e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

2. Higjenizues me bazë hipoklorit natriumi. {Sodium hypochlorite ( $\text{Na OCl}$ ) CAS no.7681-52-9} në përqendrim 12%-15%. Ky preparat duhet të përdoret për higjenizimin e tualeteve, myshkut, algave dhe si preparat për higjenizimin e sipërfaqeve dhe pajisjeve të ndryshme. Paketimi: në konfeksion plastik 5 deri 25 litra dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se  $\frac{1}{2}$  e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

3. Higjenizues me bazë komponime të amonit kuarternar. Ky preparat duhet të përdoret për higjenizimin e ambjenteve të jashtme dhe të brendshme, i përshtatshëm për pajisjet spërkatëse të tipit ULV (mjegulluese) dhe pompat me presion të ulët. Spektri i veprimit të preparatit të përfshijë eliminimin e viruseve, baktereve, kërpudhave dhe mykut. Lëndët bazë aktive e këtij preparati higjenizues duhet të jenë komponime të amonit kuarternar, dhe përbërës të tjerë të shtuar sipas produktit. Preparati të jetë në formë të lëngshme dhe i tretshëm në ujë. Destinacioni i përdorimit: Në ambiente të brendshme dhe të jashtme si zyra, qendra sociale, shkolla, kopshte, rrugë, sheshe publike, vendgrumbullime mbeturinash, holle të hapura, sheshe pushimi, ambiente pritje jashtë, rrugica hyrëse-dalëse, mure të jashtme godine, mure rrethuese. Paketimi: në konfeksion plastik 1 deri 5 litra dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se  $\frac{1}{2}$  e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

4. Adulticid për luftimin e grerëzave në fole në formë shkume. Ky produkt të jetë i gatshëm në formën e bombulave për spërkatje në formë spraji me efikasitet minimumi deri në 3 metra, për luftimin e grerëzave direkt në foletë e tyre. Valvula speciale e dërgon produktin në formë

sprucimi dhe sapo godet folenë ai shndërrohet menjëherë në një shkumë të dendur dhe mbështjellëse që pengon insektet të fluturojnë duke realizuar në një kohë të shkurtër eliminimin e tyre. Lënda bazë aktive e këtij preparati duhet të jetë adulticid i klasës Piretroide dhe përbërës të tjerë të shtuar sipas produktit. Paketimi: Në konfeksion metalik me mekanizëm sprucimi në formë aerosoli 500ml-1000ml. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

5. Insekticid për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse si milingona, miza, pleshta, rriqna, morra, për ambjente të jashtme të godinave publike, arsimore, parqet publike, kanalizimet. Lëndët bazë aktive e këtij preparati duhet të jenë të klasës Piretroide në formë mikrokapsulare me efekt të menjëhershëm dhe të zgjatur. Preparati të jetë në formë të lëngshme, i tretshëm në ujë dhe i përshtatshëm për pajisjet dezinfektuese per pompat me presion të ulët. Toksiciteti i produktit sipas përcaktimit të OBSH të jetë i nivelit të ulët ose mesatar dhe i parrezikshëm për mjedisin. Duhet të ketë efekt të menjëhershëm godites dhe toksicitet të ulët/mesatar. Paketimi: Në konfeksion plastik 100 ml - 1 lt. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

6. Insekticid për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse milingona, miza, pleshta, rriqna, morra, për ambjente të brendshme të godinave publike, arsimore, bodrumet, vendstrehimet. Lëndët bazë aktive e këtij preparati duhet të jenë të klasës Piretroide në formë e mikrokapsular te gatshme pa pasur nevojën e shtimit te preparateve te tjera per te patur nje efekt të zgjatur. Preparati të jetë në formë të lëngshme, i tretshëm në ujë dhe i përshtatshëm për pajisjet dezinfektuese dhe i pershtatshem per pompat me presion të ulët. Toksiciteti i produktit sipas përcaktimit të OBSH të jetë i nivelit të ulët ose mesatar dhe i parrezikshëm për mjedisin. Duhet të ketë efekt të menjëhershëm dhe toksicitet të ulët/mesatar duke mos lënë mbetje pas përdorimit. Paketimi: Në konfeksion plastik 100 ml-1 lt. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

7. Insekticid për luftimin e furrtareve. Lënda bazë aktive e këtij preparati duhet të jetë Imidakloprid në trajtë xheli. Toksiciteti i produktit sipas përcaktimit të OBSH të jetë i nivelit i ulët ose mesatar dhe i parrezikshëm për mjedisin. Paketimi: Në konfeksion plastik në formë shiringe jo më shumë se 50g. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

8. Rodenticid për luftimin e minjve në mjedise të hapura dhe të mbylluara. Ky preparat duhet të jetë i tipit pellet, pastabite ose block. Lënda bazë aktive e rodenticidit duhet të jetë e klasës Antikoagulantë me veprim të ngadalshëm ose kronik. Toksiciteti i produktit sipas përcaktimit të OBSH të jetë i nivelit të ulët ose mesatar i parrezikshëm për mjedisin. Për të evituar kontaktin rodenticidit me gjallesat e tjera përveç minjve dhe për t'i ruajtur nga agjentët atmosferikë duhet të jenë të veshuara me një shtresë e cila të jetë hidhëruese me anë të

lëndëve aktive si Bitrex (denatonium benzoate, CAS no. 3734-33-6) ose ekuivalentin e tij të destinuar për këtë qëllim. Paketimi: Në konfeksion plastik 0.1kg - 5kg i ndarë në copa nga 10-20g secila. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

9. Kutitë plastike për vendosjen e rodenticiteve dhe monitorimin për përdorim në mjedise të mbyllura dhe të hapura me përdorim të gjërë, ku preparati është i futur në brendësi dhe nuk ka kontakt të jashtëm dhe mundësi vendosje letër ngjitës për monitorimin e insekteve zvarritëse. Materiali i kutisë duhet të jetë rezistent ndaj agjentëve atmosferikë, shtypjeve dhe goditjeve dhe duhet të jetë i siguar me çelës sigurie për mbyllje të sigurtë. Përmasat: në formë të ndryshme me lartësi deri në 20cm me gjatësi dhe gjerësi deri 30cm dhe peshë maksimale 450g, me vrimë hyrje për minjtë me diametër 5cm-6cm.

10. Preparat repelent për largimin e gjarpërinjve dhe zvarranikëve. Ky preparat duhet të jenë i tipit repelent me formulim granular. Lënda bazë aktive e repelentit duhet të jetë natyrale e përbërë nga lloje të ndryshme vajrash bimorë e cila kur aplikohet krijon efekt mjedisi të papëlqyeshëm për zvarranikët, veçanërisht tek gjarpërinjtë dhe është e padëmshme për njerëzit, kafshët dhe shpendët. Paketimi: Në konfeksion plastik ose metalik 0.5-2 litra. Jetëgjatësia: data e skadencës së produktit në ditën e lëvrimit të mallrave duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Të gjitha paketimet e preparateve objekt prokurimi duhet të jenë të etiketuara në gjuhën shqipe referuar nenit 1 pika 1.2 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.488, datë 29.06.2016 "Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve", pikës 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.487, datë 29.06.2016 "Për klasifikimin e produkteve biocide" dhe nenit 8 të Ligjit Nr.9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve".

III.3.2. Në procesverbalin e datës 10.02.2026 "PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM " të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e specifikimeve teknike të produkteve në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, si më poshtë vijon:

#### **"II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm përbërë nga specialistë të fushës, i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", Ligjit nr.95/2015 datë 17.09.2015 "Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik", Ligjit nr.27/2016 datë 17.03.2016 "Për menaxhimin e kimikateve", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.488, datë 29.6.2016 "Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve", VKM nr.933 datë 25.11.2020 "Për përcaktimin e rregullave

*për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”.*

*Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke u bazuar në nevojat reale të përdorimit të mallrave objekt të prokurimit. Produktet e kërkuara janë të rëndësishme në ushtrimin e detyrave funksionale të autoritetit kontraktor. Këto produkte garantojnë marrjen e masave efikase për parandalimin e infeksioneve nga viruset, bakteret, kërpudhat sipas detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Karakteristikat teknike dhe përbërësit kimikë të produkteve janë kërkuar në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM nr.933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”. Standartet teknike të kërkuara janë konsultuar me bazën ligjore në fuqi ku është verifikuar përcaktimi teknik për çdo element në veçanti. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.*

*Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 5 të Dokumentave Standarte të Tenderit.*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

III.3.3. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikont se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

*dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.3.4. Neni 3 Parime të përgjithshme “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.3.5. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”

III.3.6. Neni 36 “Specifikimet teknike” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

*1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.*

*Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.*

*Në specifikimet teknike mund të specifikohet, edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.*

*Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose të projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

*2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

*3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktorë të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshirë në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/i saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.3.7. Neni 8 “Autorizimi për bërjen të disponueshme për treg të produkteve biocide” i ligjit nr. 95/2015, “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“1. Të gjitha lëndët vepruese dhe produktet biocide për kontrollin e organizmave të dëmshëm për shëndetin publik, që hyjnë, prodhohen dhe/ose përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhen të disponueshme për treg pas pajisjes me autorizim nga autoriteti kompetent.

2. Autoriteti kompetent autorizon produktet biocide, duke lejuar bërjen të disponueshme për treg në territorin e Republikës së Shqipërisë, pas paraqitjes së dokumentacionit nga personi fizik ose juridik dhe verifikimit nëse dosja i përmbush kërkesat, sipas këtij ligji.

3. Ministri përgjegjës për shëndetësinë, për raste të gjendjeve të emergjencës shëndetësore apo emergjencës civile, kur luftimi i një agjenti biologjik të dëmshëm gjykohet se nuk realizohet me produktet biocide të autorizuar, autorizon importimin dhe përdorimin e kufizuar të produkteve biocide të paautorizuara përmes procesit normal të bërjes së disponueshme për treg. Autorizimi është i vlefshëm për një periudhë deri në 4 muaj dhe për një sasi të argumentuar nga Instituti i Shëndetit Publik, sipas emergjencës.

4. Autorizimi për vendosjen në treg të produkteve biocide lëshohet për:

a) produkte biocide të prodhuara në vend;

b) produkte biocide të autorizuar në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian, në Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Turqi, Izrael dhe Australi;

c) produktet biocide të prodhuara dhe të autorizuar në vendet e Ballkanit.

5. Rregullat për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe procedurën e dhënies së autorizimit të vendosjes në treg të produkteve biocide përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave..”

III.3.8. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 933, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg” është vendosur që:

“1. Përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes në treg të produkteve biocide.

2. Bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij janë:

a) shtojca I: Kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe procedura e dhënies së autorizimit të vendosjes në treg të produkteve biocide;

b) shtojca II: Kërkesat për informacion për lëndët vepruese;

c) shtojca III: Kërkesat për informacion për produktet biocide;

ç) shtojca IV: Përmbajtja e autorizimit për produktet biocide;

d) shtojca V: Lista e lëndëve vepruese të miratuara.....”

III.3.9. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoritetet kontraktorë në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë

gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktorë duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktorë duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktorë të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksional sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra,

shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohen në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”*.

Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet *“Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për siguri të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”*

Ndërsa në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: *“specifikim teknik”* nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin

produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Cëshjta C-368/10 “Komisioni European vs. Mberëtëria e Hollandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”*

III.3.10. Nga ana e operatorit ekonomik ankimues nuk është argumentuar se ky specifikim teknik është hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik dhe se si këto specifikime ngushtojnë konkurrencën por hedh dyshime për produktet insekticide që tani janë bërë biocide me lënd aktive si deltametrinë, cipermetrinë dhe ekujvalent sipas të dhënave të cituara në etiketë nuk mund të përdoren në ambientet e jashtme dhe për këtë arsye nuk janë më të përdorshme me sistemet ULV ose në ndonjë metodë tjetër me nebulizim në një mjedis të jashtëm. Këto produkte mund të importohen vetëm nëpërmjet një kanali tjetër që është Ministria e Bujqësisë, por në këtë rast produktet duhet të përdoren për të luftuar insektet e bimëve dhe mbi produktet bujqësore, për këtë arsye kjo do të ishte në kundërshtim me indikacionet në etiketë. Nga AK është kërkuar një tjetër gamë insektetsh që është ajo urbane, dhe nëse pranohet që produktet të jenë futur si produkte bujqësore kemi të bëjmë me përdorim jo të duhur dhe të paautorizuar. Po kështu, e njëjta gjë vlen edhe për dezinfektuesit, të cilët duhet të jenë gjithmonë të autorizuar për sasinë e importuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe jo këto produkte të importohen si produkte për përdorim veterinar apo për ferma (të autorizuar nga Ministria e Bujqësisë), por për mjedise civile, spitale, shtëpi, industri ushqimore etj.

III.3.11. Autoriteti Kontraktor në shkresën nr.851/3 prot., datë 02.03.2026 me objekt “Kthim përgjigje ankesës së operatorit ekonomik” ka sqaruar në lidhje me këtë prendim se “bazuar në dokumentat e tenderit dhe procesverbalin dhe argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë për të shmangur paqartësi por edhe për të shmangur pretendimet e paraqitura në këtë ankesë autoriteti kontraktor ka vendosur kriterin në pikën 202..3 i cili përcakton se *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim për bërjen të disponueshme në treg ose autorizim importi të produkteve biocide për kontrollin e organizmave të dëmshëm në shëndetin publik, të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale sipas legjislacionit në fuqi.* Bazuar në këtë kriter vetëm mallrat e ofruara të autorizuar nga Ministria e Shëndetsisë do të kualifikohen.

III.3.12. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me shërbimin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendose kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuze, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është në të drejtë të autoritetit kontraktor të përcaktojë, në lidhje me “Blerje preparate për dizinfektim, dezinfektim dhe deratizim” specifikime teknike dhe parametra të caktuara, me qëllim performancën sa më të mirë të shërbimit të cilat nuk bien ndesh me parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik apo me parashikimet e nenit 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Duke qenë se në në ligjin nr. 95/2015, “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” është përcaktuar qartë që të gjitha lëndët vepruese dhe produktet biocide për kontrollin e organizmave të dëmshëm për shëndetin publik, që hyjnë, prodhohen dhe/ose përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhen të disponueshme për treg pas pajisjes me autorizim nga autoriteti kompetent si dhe me VKM Nr.933, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg” është miratuar lista e lëndëve vepruese të miratuara, listë e cila është në fuqi dhe e publikuar në Fletoren zyrtare nr.210, datë 02.12.2020, KPP gjykon se specifikimet teknike të produkteve objekt ankimi janë vendosur në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në hartimin e specifikimeve teknike në lidhje me specifikimet e mësipërme nga ana e autoritetit kontraktor ky tregues është hartuar në mbështetje të listës së miratuar nga Ministria e Shëndetsisë të cilat nuk sjellin kufizim të konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë. Për më tepër në përgjigjen e saj drejtuar operatorit ekonomik ankimues ka nënvizuar kërkesën lidhur me kualifikimin e vetën atyre produkteve të cilat janë të autorizuar nga Ministria e Shëndetsisë. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në hartimin e specifikimeve teknike në lidhje me specifikimin e mësipërm nga ana e autoritetit kontraktor ky tregues është hartuar në përputhje me nenin 36 pika 3 gërma “b” “*standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve*

*kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;*”, në vendimin Nr. 933, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg” si dhe në ligjin nr. 95/2015, “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”.

### **Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.**

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me REF-76114-02-13-2026 me objekt: “Blerje preparate për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim”, me fond limit 55 581 450 (pesëdhjetë e pesë milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH ose 575 734.9 (pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër pikë nëntë) euro pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 18.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

